



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.3.2023

Nr: 168

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 24 SHKURT – 2 MARS 2023**

Sot, më datë 11.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBEKT: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Banka e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Prefekti i Qarkut Tiranë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Qendra Kombëtare e Biznesit-Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier, Bashkia Tiranë, Bashkia Belsh, Bashkia Dibër, Bashkia Divjakë, Bashkia Durrës, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Kavajë, Bashkia Korçë, Bashkia Lezhë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Maliq, Bashkia Mallakastër, Bashkia Patos, Bashkia Pogradec, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Sarandë, Bashkia Tepelenë.

OBJEKTI: Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 shkurt deri më 2 mars 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e

veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 24 shkurt deri më 2 mars 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 319 aktivitete, nga 72 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 57 aktivitete të zhvilluara nga 31 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Më datë 3.3.2023, administrata e KQZ - së i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t’u paraqitur në seancën publike të datës 8.3.2023, ora 11:00. Palët e interesuara depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Intervistë për informimin e publikut për Skemat e Përvitshme Kombëtare të Mbështetjes për fermerë”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet emailit të datës 9.3.2023 ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *“Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ka dhënë vëmendje të veçantë detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Me këtë rast shprehim angazhimin që në vijimësi do të raportojmë aktivitetet sipas afateve të përcaktuara dhe duke dhënë gjithë informacionin e nevojshëm. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë të gjitha masat për raportim të aktiviteteve sipas parashikimeve ligjore. Për sa i përket aktiviteteve që janë brenda periudhës së raportimit sqarojmë si vijon: Aktivitet *“Intervistë për informimin e publikut për Skemat e Përvitshme Kombëtare të Mbështetjes për fermerë”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023. Projektvendimi për të cilin u zhvillua intervista informuese u miratua në Mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 1 mars 2023 dhe është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2023, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për miratim në 4-mujorin e parë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022 *“Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”*. Vendimi i miratuar nuk është në segmentin e akteve që nuk duhet të miratohen në periudhën zgjedhore sipas nenit 91 dhe 92, të Ligjit Nr. 10019, datë*

29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, pasi: Procesi i hartimit ka filluar sipas urdhërit nr. 407, datë 16.9.2022, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe është në vijimësi; Është parashikuar për miratim në VKM-në nr. 862, datë 27.12.2022; Një vendim i tillë miratohet çdo vit bazuar në buxhetin vjetor; Miratimi i vendimit është ndjekur çdo vit nga një fushatë e gjerë informimi.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes për projektin RiSI Albania”, raportuar në datë 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.2.2023.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë nëpërmjet email-it të datës 8.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Për sa i takon mospërbushjes së një prej afateve të deklarimeve të eventeve të MFE-se, lidhur me të cilin më lejoni t’ju sqaroj se kjo situatë është krijuar si pasojë e një gabimi njerëzor në përlllogaritjen e ditëve të deklarimit, dhe pa pasur një arsye tjetër të qëllimshme për mosraportim aktiviteti apo për raportim të pjesshëm.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, tematika e aktivitetit të raportuar përbën veprimtari me karakter administrativ në përmbushje të funksioneve të vetë institucionit.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktivitet në Spitalin Memorial Fier”, raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.

- Aktivitet “Vizitë në Qendrën Shëndetësore Fier”, raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.

- Aktivitet “Aktivitet mbi dentistrinë e lëvizshme në Fier”, raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Por duke marrë në konsideratë dinamikat dhe rrethanat të cilat ndonjëherë janë përtej mundësive tona parashikuese, mund të ndodhin ndryshime të momenteve të fundit në agjendën e Ministres. Megjithatë ne jemi munduar ti paraprijmë këtyre ndryshimeve duke raportuar çdo aktivitet me karakter publik. Në lidhje me aktivitet e raportuara të sjella në vëmendje, ju bëjmë me dije se këto aktivitete nuk janë zhvilluar ende dhe janë ripublikuar në ndërfaqe për t’u zhvilluar me datë 9.3.2023.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktivitetet e sipërcituara nuk janë zhvilluar në datën e raportuar, por janë ripublikuar për tu zhvilluar në datën 9.3.2023. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria e raportuar është raportuar brënda afatit ligjor.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ftesë në takimin për pjesëmarrjen e gruas në sipërmarrje”, raportuar në datë 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.

Ministria e Turizmit nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Në vijim të emailit të mëposhtëm, lidhur me aktivitetin e zhvilluar në Vlorë, “Ftesë në takimin për pjesëmarrjen e gruas në sipërmarrje”, në të cilën ka marrë pjesë znj. Vilma Bello, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, si e ftuar në këtë aktivitet ju bëjmë me dije se publikimi i këtij aktiviteti, në faqen e KQZ-së, është bërë më datë 27.2.2023, katër ditë para zhvillimit të aktivitetit për arsye se ky aktivitet është organizuar nga një institucion tjetër dhe prezenca e znj. Bello nuk ka qenë e sigurt në këtë aktivitet për shkak të agjendës së ngarkuar të punës. Menjëherë pas konfirmimit nga ana e znj. Bello për pjesëmarrje në këtë aktivitet, kemi raportuar në faqen e KQZ-së.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Turizmit nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për

të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Seancë Plenare”*, raportuar në datë 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.

Ministria e Kulturës nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023 dhe shkresës bashkëlidhur e-mailit nr. 1192 prot., datë 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Lidhur me aktivitetin “Seancë plenare”, ju informojmë se nuk është një veprimtari e planifikuar për t’u organizuar nga Ministria e Kulturës apo institucionet e saj të varësisë, por është një aktivitet i cili zhvillohet nga Kuvendi, që është dhe vetë institucioni që ka detyrimin e raportimit për këtë veprimtari. Megjithatë, në konsideratë të parashikimit lidhur me raportimin e veprimtarive publike 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është njoftuar me përgjegjshmëri ligjore në të njëjtën datë në të cilën Ministria e Kulturës ka marrë njoftim për zhvillimin e këtij aktiviteti.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Kulturës nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

6. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. *“Vizitë në shkollën 9-vjecare “Lef Sallata” në orën 11:00, datë 6 mars, në kuadër të programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM) dhe Programit të Kodimit. Me këtë rast, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi do të vizitojë dhe takojë nxënësit që ndjekin kurset tematike që zhvillohen ditën e hënë: piktura, teatri, kori, zejet dhe sporti”*, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 6.2.2023.

2. "Pjesëmarrje në seksionin e kongresit të shëndetësisë lidhur me adresimin e sfidave dhe nevojave të shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve", raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 7.2.2023.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nëpërmjet e-mail-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "Aktiviteti "Vizitë në shkollën 9-vjecare Lef Sallata' në orën 1 1:00, datë 6 mars, në kuadër të programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM) dhe Programit të Kodimit" është raportuar më datë 28.2.2023 dhe është zhvilluar më datë 6.3.2023. <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/28/vizite-ne-kuader-te-programit-jashte-orarit-mesimor-jom-dhe-programit-te-kodimit/>

Në këtë rast ka ndodhur një gabim njerëzor gjatë hedhjes së të dhënave, përkatësisht shënimi i muajit shkurt në vend të muajit mars, për datën e zhvillimit të aktivitetit.

Aktiviteti "Pjesëmarrje në seksionin e kongresit të shëndetësisë lidhur me adresimin e sfidave dhe nevojave të shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinive", është raportuar më 28.2.2023 dhe është zhvilluar më datë 7.3.2023.

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/02/28/pjesemarrje-ne-kongresin-e-shendetesise/>

Edhe në këtë rast ka ndodhur i njëjti gabim njerëzor gjatë hedhjes së të dhënave përkatësisht shënimi i muajit shkurt në vend të muajit mars, për datën e zhvillimit të aktivitetit."

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se në të dy aktivitetet e raportuara, është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Data e zhvillimit të aktivitetit është shënuar 6.2.2023 dhe 7.2.2023 por duhet të ishte shënuar 6.3.2023 dhe 7.3.2023, data në të cilat janë zhvilluar aktivitetet, e cila është e kuptueshme edhe nga tematika e veprimtarive lidhur me festën e 7-8 marsit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së dhe vlerëson se raportimi është kryer brenda afatit ligjor.

7. Banka e Shqipërisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktivitet "Takim i Guvernatorit me përfaqësuesit e Bankës Botërore", raportuar në datë 24.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.2.2023.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: "Në vijim të emailit tuaj, ju bëjmë me dije se ky aktivitet nuk ka qenë i parashikuar më parë në kohë. Banka Botërore ka kërkuar prezencën e Guvernatorit në këtë aktivitet dhe konfirmimi është dhënë në momentin e fundit në bazë të agjendës së Guvernatorit. Gjithashtu, dalja me njoftim për shtyp ka qenë subjekt konfirmimi dhe i Bankës Botërore gjë që ka marrë kohën e vet dhe jo vetëm që nuk mund të parashikohej paraprakisht, por mund të rezultonte edhe në mos aprovim prej tyre. Pas

konfirmimeve përkatëse nga Banka Botërore dhe Banka e Shqipërisë aktiviteti është publikuar dhe raportuar menjëherë pranë institucionit tuaj”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, nisur nga tematika e aktivitetit të zhvilluar dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, lidhet me ushtrimin e detyrave funksionale të institucionit dhe nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari.

8. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Drejtorja e Përgjithshme e AKPA, Dhoma e Industrisë së Tregtisë, gjatë muajit mars 2023, do të organizojnë panairin *Ëork&Study 2023*”, raportuar në datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 1.3.2023
- Aktivitet “Drejtorja e Përgjithshme e AKPA , Dhoma e Industrisë së Tregtisë, gjatë muajit mars 2023, do të organizojnë panairin *Work &Study 2023*”, raportuar në datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2023.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë, nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Në këto aktivitete AKPA është në cilësinë e të ftuarit dhe jo organizator i eventit. Panairët e Punës, Work & Study, janë një traditë aktivitetesh që zhvillohen prej shumë vitesh. Këto panire organizohen nga DHTIT në nivel rajonal dhe më pas përmbillen në një event të madh në Tiranë (sivjet do të realizohet në fund të muajit mars 2023). Në këtë aktivitet DHTIT, fton të marrin pjesë Universitetet më të mëdha në vend, organizata të ndryshme, punëdhënës që kërkojnë të rekrutojnë fuqi punëtorë, dhe sipas rastit institucione te interesuara. Për vete funksionet qe AKPA kryen, si ndërmjetës në tregun e punës, është e domosdoshme pjesëmarrja ne këtë event si të ftuar kryesor”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këto aktivitete për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Kronikë në TV Klan në lidhje me ecurinë e regjistrimit fillestar të pronave në Jug të vendit”*, raportuar në datë 28.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 4.3.2023.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nëpërmjet email-it të datës 8.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Kronika e transmetuar në TV Klan ishte një kronikë e kërkuar vetë nga televizioni, qëllimi tyre ishte të plotësojnë hapësirën televizive me temën “Për të informuar publikun në lidhje me funksionimin e procesit të regjistrimit fillestar”, Regjistrimi fillestar konsiston në pasqyrimin e çdo pasurie të paluajtshme shtetërore, publike dhe private të zonës kadastrale, në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale të zonës. Kjo një detyrë funksionale e ASHK, e cila nuk ka lidhje me shpërndarjen e titujve të pronësisë. Në lidhje me këtë situatë, ju bëjmë me dije së institucioni ynë shpesh herë përballet me kërkesa të tilla, ku Kadastra ftohet për të dhënë informacion mbi mënyrën e zhvillimit të punës së saj”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këto aktivitete për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

10. Prefekti i Qarkut Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Aktivitet pastrimi ambientit në Bashkinë Rrogozhinë”*, raportuar në datë 1.3.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.

Prefekti i Qarkut Tiranë nëpërmjet përfaqësuesit të vet me autorizim, i pranishëm në seancë publike, ka sqaruar se *“Për arsye teknike është bërë e pamundur që nga dita e hënë të raportohet ky aktivitet. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë ka kontaktuar KQZ-në, e cila na ka orientuar për të dërguar email. Email është dërguar në adresën aktivitete@kqz.gov.al por pa përgjigje. Ndërkohë sot, personi i kontaktit shkoi fizikisht pranë KQZ-së për t’i dhënë zgjidhje këtij problemi. Pas ridërgimit të email-it për kredenciale u bë i mundur raportimi i aktivitetit që do të zhvillohet me datë 3.3.2023. Theksojmë se aktiviteti që do të zhvillohet ishte i planifikuar nga Bashkia Rrogozhinë dhe Institucioni i Prefektit është i ftuar për tu bashkuar nismës së tyre për pastrim.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Prefekti i Qarkut Tiranë nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këto aktivitete për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Lidhur me pretendimin e Prefektit i Qarkut Tiranë se nuk është pajisur me të dhënat për të hyrë në sistem, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve sipas hetimit të kryer konstaton se, administrata e KQZ-së që në fillim të periudhës 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, nëpërmjet email-it aktivitete.kqz.gov.al, i ka dërguar kredencialet Prefekti i Qarkut Tiranë për të hyrë në sistem.

Megjithatë edhe në rast se institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, sipas nenit 4 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, mund të dërgojnë raportimin nëpërmjet email – it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor.

11. Autoriteti i Aviacionit Civil ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *"Intervistë e drejtorit ekzekutiv Z. Maksim Et'hemaj në RTSH nga Znj. Aurora Pengu për të folur mbi fluksin e udhëtarëve në aeroportin Nënë Tereza në nisje të sezonit turistik"*, raportuar në datë 26.2.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.2.23.
- Aktivitet *"Intervistë mbi auditin ndërkombëtar të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC), në Aeroportin e Tiranës"*, raportuar në datë 1.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 2.3.2023.

Autoritet i Aviacionit Civil, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023 dhe shkresës nr. 550 prot., datë 3.3.2023 administruar me tonën nr. 1340 prot., datë 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *"Referuar Aktivitetit me temë: "Intervistë e Drejtorit Ekzekutiv Z. Maksim Et'hemaj në RTSH nga Znj. Aurora Pengu për të folur mbi fluksin e udhëtarëve në aeroportin Nënë Tereza në nisje të sezonit turistik",.... ju informojmë se ky aktivitet organizohej nga TVSH, dhe të gjithë aktivitetin janë të detyruar ta monitorojnë organizatorët, në këtë rast TVSH. ...Referuar aktivitetit me temë: "Intervistë mbi Auditin Ndërkombëtar të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC), në Aeroportin e Tiranës, ..., jemi në dijeni të afatit të ngushtë të raportimit, por për efekt transparence sqarojmë se gazetari Maksi Rama, i Klan Neës ka kontaktuar këshilltarin e medias pranë AAC si dhe koordinatorin për të drejtën e informimit në orën 17:04 minuta të datës mars 2023 nëpërmjet emailit ku i kërkon zhvillimin e një interviste JO LIVE (thjesht do të regjistrohej) me Drejtorin Ekzekutiv, në ambientet e*

AAC, mbi një tematikë tërësisht teknike mbi Auditin Ndërkombëtar të Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (ECAC) në Aeroportin e Tiranës, intervistë kjo e cila do të zhvillohej jo publike në datën 2 mars dhe do të transmetohej në media, 5 ditë pas raportimit, dakordësuar kjo me gazetarin. Pra vendosja e datës 2 nga ana jonë është për efekt transparence që thjesht po ju njoftojmë se do të zhvillohet diçka e tillë në ambient të mbyllur dhe do të publikohet 5 ditë pas afatit të raportuar. Duke mos ekzistuar një opsion i tillë në faqen tuaj të raportimit sa i përket datës së zhvillimit dhe datës së publikimit, vijnë efektet e keqkuptimit të ndodhur nga ana juaj. ...Mbetet e rëndësishme për të theksuar që të dyja këto veprimtari, nuk bien nën asnjë nga parashikimet e nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.20201 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve" ku përcaktohen veprimtaritë ndaluara".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se, për të dy aktivitetet e raportuara, Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

12. Qendra Kombëtare e Biznesit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktivitet "Takim online me të ftuar nga grupet e interesit me tematikë "Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 tre angazhimet prioritare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur", raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 27.2.2023.

Qendra Kombëtare e Biznesit nëpërmjet emailit të datës 6.3.2023 ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: "Qendra Kombëtare e Biznesit është institucion i administratës shtetërore i angazhuar në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP), ku Republika e Shqipërisë është pjesë. Këto angazhime të ndërmarra nga institucioni ynë lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese. Në kuadër të OGP u kërkua nga Kryeministria zhvillimi i një takimi me subjektet raportuese dhe grupet e interesit, ku të diskutohet mbi to dhe Planin e Veprimit që përmban aktivitetet që do të zhvillohen për secilin prej angazhimeve brenda datës 27-28 shkurt. Në këto kushte u morën masa

urgjente për zhvillimin e takimit, i cili u organizua online pikërisht për shkak të afatit të ngushtë që kishim në dispozicion për zhvillimin e tij. Në të njëjtën kohë që u përgatitën materialet për takimin, njoftimi i subjekteve etj., u hartua edhe shkresa Nr. 4760 Pro.t, datë 23.02.2023, për njoftimin e KQZ-së në kuadër të detyrimeve për raportimin e veprimtarive me karakter publik. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga OGP-ja, institucioni ynë për takimin online të zhvilluar me datë 27.02.2023, ora 11:00, ka njoftuar grupet e interesit nëpërmjet një e-mail të datës 22 shkurt 2023, me tematikë: “Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 (tre) angazhimet prioritare, të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership-OGP) dhe Planit të Veprimit me grupet e interesit”, ku do të prezantohen Angazhimet Prioritare të QKB-së dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetit për Qeverisje të Hapur 2022-2024. Për sa më sipër sqarojmë se, ky takim nuk ishte një takim i parashikuar më parë nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe njoftimi i KQZ-së është bërë në afate shumë të ngushta për shkak të emergjencës së konsultimit me grupet e interesit të aktiviteteve që do të kryhen në vijim në kuadër të tre angazhimeve. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin dëshirojmë të theksojmë se, QKB-ja ngelet e angazhuar për respektimin e çdo detyrimit ligjor që rrjedh nga legjislati në fuqi për periudhën e zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, krijoi bindjen se tematika e aktivitetit të raportuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përbën veprimtari me karakter administrativ në përmbushje të funksioneve të vetë institucionit. Në këto kushte nuk jemi përpara një veprimtarie që duhet të raportohet në ndërfaqen e KQZ -së.

13. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë organizon një koncert ku performues do të jenë nxënës dhe mësues të tre shkollave artistike në varësi të DRAP Korçë që janë “Ajet Xhindole Berat” “Tefta Tashko Koco Korçe” dhe “Onufri Elbasan”, me rastin e festës së mësuesve”, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se “Koncerti i organizuar është një aktivitet kulturor, me institucionet e varesise sic janë tre shkollat artistike ku performues janë nxënës të shkollave. Aktiviteti ishte planifikuar për tu organizuar në datën 7 Mars 2023. Për shkak të organizimit masiv si dhe për shkak të largesise nga Korça të dy prej tre shkollave, aktiviteti u afrua në ditën e shtunë date 04.03.2023. Për këtë sapo u vendos data e organizimit, u bë raportimi pra data 28.02.2023.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, krijoi bindjen se, mbështetur edhe në tematikën e aktivitetit që lidhet me pjesëmarrjen e disa shkollave dhe pamundësinë e tyre për ta organizuar më vonë, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë nuk ka patur mundësinë të raportojë brenda afatit ligjor. Në këto kushte, të aktiviteteve të nevojshme dhe të domosdoshme për tu kryer, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, duke mos e sanksionuar.

14. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Aktivitet me rastin e 7 marsit, ditës së mesuesit”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 6.3.2023.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier nëpërmjet email-it të datës 3.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *–“Raportimi i aktivitetit në datën 2 mars nuk ka patur si qëllim kurrsesi shkejen e afateve ligjore, por aksesi në ndërfaqen e KQZ na është dhënë pikërisht në këtë datë: 2.3.2023. Me të marrë këtë akses e kemi raportuar menjëherë. Ky aktivitet nuk ka asnjë lidhje me fushatën zgjedhore apo politikën, por është një koncert festiv me rastin e Ditës së Mësuesit. Është një aktivitet i kthyer në traditë ku marrin pjesë mësuesit në shërbim dhe ata në pension, si një vlerësim në shenjë mirënjohjeje dhe falenderimi për përkushtim dhe punën e palodhur që bëjnë dhe kanë bërë ndër vite për brezat e rinj. Kryetari i Bashkisë, tradicionalisht është i ftuar në këtë koncert festiv si qytetari i parë dhe ka vetëm një fjalë përshëndetëse shumë të kufizuar që nuk i kalon kufijtë e festës. Ky është një aktivitet festiv që tradicionalisht organizohet çdo 6 mars në Fier, me qëllim që në 7 mars, mësuesit ta kalojnë këtë festë me nxënësit në shkolla, për të nxitur edhe më shumë lidhjen mësues – nxënës.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier ka marr akses në ndërfaqe në datën 2.3.2023 dhe nuk ka pasur mundësinë të përmbushë afatin ligjor për raportimin e këtij aktiviteti.

Pavarësisht kësaj, edhe në rast se institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, sipas nenit 4 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, mund të dërgojnë raportimin nëpërmjet email – it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton situatën e krijuar në këtë rast, duke mos sanksionuar Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier.

15. Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “*Takim me zonjat për 8 Mars – Kamëz*”, raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 8.2.2023.

2. Aktivitet “*Takim me zonjat për 8 Mars – Kavajë*”, raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.2.2023.

3. Aktivitet “*Finalja e Kupes Shqiperise meshkuj Tirana-Erzeni*”, raportuar më 1.3.2023 dhe datë zhvillimi 5.3.2023.

Bashkia Tiranë nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Më poshtë po ju japim informacionin sqarues në lidhje me 3 aktivitetet objekt i ketij email. Në lidhje me dy vepmprimtaritë e para, takim me zonjat për 8 mars ne Kamëz dhe Kavajë të raportuara në datë 27.02.2023 për tu zhvilluar më datë 08.02.2023, është një lapsus gjatë raportimit, për shkak se kishim të bënim me muajin pasardhes. Për këtë arsye, në ndërfaqe është kryer raportimi i këtyre dy aktiviteteve po në datë 27.02.2023 dhe zhvillimi i tyre për më datë 08.03.2023. Po kështu, vihet re që tema e vepmprimtarive është ditë ndërkombetare e gruas, datë 08 mars dhe takimet kanë të bëjmë me datën 08 mars dhe jo me datën 08 shkurt. Ky argumentim është lehtësisht i vërtetueshëm në raportimin e kryer në ndërfaqen tuaj. Në lidhje me vepmprimtarinë e 3 për të cilën kërkohet informacion sqarues, ju bëjmë me dije se pjesëmarrja e kryetarit të bashkisë në këtë aktivitet është anuluar dhe nuk ka marr pjesë. Ky informacion është i verifikueshëm pasi nuk ka publikim që kryetari i bashkisë të ketë marr pjesë apo promovuar këtë aktivitet.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se në aktivitetet e raportuara 1 dhe 2, është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Data e zhvillimit të aktivitetit është shënuar 8.2.2023 dhe 4.2.2023 por duhet të ishte shënuar 8.3.2023 dhe 4.3.2023, data në të cilat janë zhvilluar aktivitetet, e cila është e kuptueshme edhe nga tematika e veprimtarive lidhur me festën e 7-8 marsit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së dhe vlerëson se raportimi është kryer brenda afatit ligjor.

Lidhur me aktivitetin e tretë të raportuar me vonesë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura dhe nga hetimi i kryer, vlerëson se aktiviteti nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

16. Bashkia Belsh ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inspektim në rrugën Belsh-Stanaj dhe bashkëbisedim me banorët e fshatit”*, raportuar në datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2023.
- Aktivitet *“Takim me aktorët e biznesit, fermerë, prodhues, shoqeri civile për themelimin e GVV@Belsh”*, raportuar në datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2023.
- Aktivitet *“Takim me koordinatorët edhe strukturat e PS për problemet e fushatës”*, raportuar në datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datë 3.3.2023.

Bashkia Belsh, nëpërmjet email-it të datës 5.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Lidhur me 3 takimet e raportuara nga Bashkia Belsh më datë 27.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 3.3.2023 përtej limiteve të afatit 5 ditor, Ju sqarojmë se për datat 23-26 ka patur mungesë interneti në Bashki. Theksojmë që në vazhdim do të jemi korrekt me afatet ligjore të raportimit”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se Bashkia Belsh ka patur probleme me internetin dhe për këtë arsye kanë raportuar aktivitetet e zhvilluara me vonesë.

Në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkaktohen për shkaqe të pavarura nga institucioni, tërheq vëmendjen Bashkisë Belsh që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email – it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

17. Bashkia Dibër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inspektim i punimeve në njësinë Kastriot”*, raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 6.2.2023.
- Aktivitet *“Diskutim me banorët e Njësisë Administrative Peshkopi”*, raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 7.2.2023.
- Aktivitet *“Takim me banorët e Njësisë Administrative Fush-Cidhen për problematikat në lidhje me vaditjen dhe mirëmbajtjen e Rrugëve”*, raportuar në datë 28.2.2023 për tu zhvilluar në datë 9.2.2023.

Bashkia Dibër nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktivitetet e raportuara në datat e vendosura janë një gabim material nga ana jonë pasi: aktiviteti “Inspektim i punimeve në njësinë Kastriot” raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 6.2.2023 realisht është parashikuar në datën 6.3.2023. Aktiviteti me temë: “Diskutim me banorët e Njësisë Administrative Peshkopi” raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 7.2.2023, realisht është parashikuar në datën 7.3.2023. Aktiviteti “Takim me banorët e Njësisë Administrative*

Fush-Cidhen për problematikat në lidhje me vaditjen dhe mirëmbajtjen e Rrugëve”, raportuar në datë 28.2.2023 për tu zhvilluar në datë 9.2.2023 realisht është parashikuar në datën 9.3.2023.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Bashkia Dibër ka kryer një gabim material për datën e zhvillimit të aktivitetit. Në kushtet kur aktiviteti i raportuar ka ndodhur për shkak të ndryshimit të formatit të kalendarit të ndërfaqes, në momentin e kryerjes së raportimeve, nga datë/muaj/vit në muaj/datë/vit dhe duke mirëkuptuar situatën, meqenëse raportime për aktivitetet janë bërë në datë 27 dhe 28 shkurt, vlerësohet se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, pasi aktivitetet janë zhvilluar në datat 6 dhe 7 mars 2023, pra, raportimi është bërë në afat.

18. Bashkia Divjakë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Bashkëbisedim me një subjekt tregtar që zhvillon aktivitetin e tij në fushën e bujqësisë në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, me qëllim informimin mbi problematikat e vështirësitë që kanë”,* raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 3.3.2023

Bashkia Divjakë nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Për veprimtarinë me temë: “Bashkëbisedim me një subjekt tregtar që zhvillon aktivitetin e tij në fushën e bujqësisë në fshatin Çermë e Sipërme, Njësia Administrative Tërbuf, me qëllim informimin mbi problematikat e vështirësitë që kanë”, raportuar në datë 27.2.2023 për tu zhvilluar në datë 3.3.2023”, ju sqaroj se ky ka qenë një gabim në momentin e shkrimit të datës së zhvillimit të takimit, i cili nuk është konstatuar nga ana ime më pas. Takimi në fjalë nuk është zhvilluar më datë 3.3.2023, por në datën 4.3.2023, duke përmbushur kështu detyrimin e raportimit 5 (pesë) ditë përpara të zhvillimit të veprimtarisë. Bashkëlidhur po ju dërgoj postimin që deputeti Taulant Balla ka bërë në rrjetin social Facebook, për këtë takim, i cili është zhvilluar ditën e Shtunë, date 4.3.2023;*

<https://fb.watch/j5vEI4FUpl/?mibextid=qC1gEa>”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se Bashkia Divjakë ka kryer një gabim material për hedhjen e datës së zhvillimit të aktivitetit i cili është i kuptueshëm pasi bëhet fjalë vetëm për një ditë ngatërrese. Në këto kushte vlerësohet se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative pasi dita e raportimit dhe zhvillimit të aktivitetit, respekton afatin 5 (pesë) ditor të raportimit të veprimtarive.

19. Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inagurim i shkollës “Dhosi Liperi” në Njësinë Administrative Sukth”*, raportuar në datë 28.2.2023 për tu zhvilluar në datë 7.2.2023

Bashkia Durrës nëpërmjet email-it të datës 3.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti me temë: Inagurim i shkollës “Dhosi Liperi” në Njësinë Administrative Sukth”, raportuar në datë 28.2.2023 për tu zhvilluar në datë 7.2.2023, është bërë një lapsus nga ana jonë për sa i përket datës sepse aktiviteti nuk është bërë akoma dhe organizohet më datë 7.3.2023, gabimisht muaji është shtypur gabim.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se, aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e një lapsusi në hedhjen të dhënave, të kryer nga Bashkia Durrës. Nisur edhe nga hetimi i kryer, konstaton se ky aktivitet nuk është publikuar në asnjë prej rrjeteve sociale të Bashkisë Durrës.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së.

20. Bashkia Gjirokastrë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Mbledhje e rradhës për muajin Shkurt”*, raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.
2. Aktivitet *“Sistemimi i kolektorëve të ujërave të bardha përgjatë segmenteve rrugore, Njësia Administrative Cepo”*, raportuar në datë 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.
3. Aktivitet *“Organizimi i festivalit Folklorik të Bashkisë Gjirokastrë, në kuadër të Festivalit Folklorik Kombëtar Qershor 2023”*, raportuar në datë 1.3.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.
4. Aktivitet *“Olimpiadë në Fizikë, Gjuhë Shqipe, Letërsi, Kimi”*, raportuar në datë 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Bashkia Gjirokastrë nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, konstaton se tematika e aktiviteteteve 1, 3 dhe 4 *“Mbledhje e rradhës për muajin Shkurt”*, *“Organizimi i festivalit Folklorik të Bashkisë Gjirokastrë, në kuadër të Festivalit Folklorik*

Kombëtar Qershor 2023”, dhe “Olimpiadë në Fizikë, Gjuhë Shqipe, Letërsi, Kimi” që janë raportuar jashtë afatit ligjor, për sa informacion jepet në ndërfaqe, përbëjnë veprimtari administrative që lidhen me veprimtarinë funksionale të institucionit.

Lidhur me aktivitetin e dytë të raportuar me vonesë me temë *“Sistemimi i kolektorëve të ujërave të bardha përgjatë segmenteve rrugore, Njësia Administrative Cepo”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga sa informacion jepet në njoftimin e kryer, nuk krijon bindjen mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

21. Bashkia Kavajë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Bashkëbisedim, për punët e bëra nga Bashkia këtë mandat 4 (katër) vjeçar, me banorët e fshatit Rrakull të njësisë Administrative Synej”*, raportuar në datë 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 6.2.2023.

Bashkia Kavajë, nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“Ju informoj se aktiviteti është zhvilluar dje, më datën 6.3.2023. Data është shënuar nga ana ime duke bërë gabim në muajin duke u deklaruar (6.2.2023) në këtë datë nuk ka pasur aktivitet nga ana jonë. Aktiviteti i lartpërmendur është zhvilluar dje më datë 6.3.2023 në orën 18:00 dhe do të postohet në rrjetet sociale të Kryetarit në ditët ne vijim.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se, aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e një lapsusi në hedhjen të dhënave, të kryer nga Bashkia Kavajë. Nisur edhe nga hetimi i kryer, konstaton se ky aktivitet nuk është publikuar në asnjë prej rrjeteve sociale të Bashkisë Kavajë.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së.

22. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon,

1. Aktivitet *“Prezantimi i Strategjisë së Turizmit të Rajonit të Korçës në kuadër të Projektit të Rezervës Ndërkufitare të Biosferës së Prespës”*, raportuar në datë 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.
2. Aktivitet *“Me rastin e festës së mësuesit Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë fton Kryetarin e Bashkisë Korçë të bëhet pjesë e koncertit që organizohet nga tre*

shkolla të rajonit Korçë, Elbasan dhe Berat”, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.

Bashkia Korçë, nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *Aktiviteti “Prezantimi i Strategjisë së Turizmit të Rajonit të Korçës në kuadër të Projektit të Rezervës Ndërkufitare të Biosferës së Prespës” (datë zhvillimi 02.03.2023) është raportuar në datë 27.02.2023 pasi ftesën për të qenë pjesë e këtij aktiviteti e kemi marrë ditën e dielë, datë 26.02.2023. 2. Ftesa për të qenë pjesë e koncertit të organizuar nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë (datë zhvillimi 04.03.2023) është dërguar në datë 01.03.2023 dhe për këtë arsye kemi bërë konfirmimim dhe raportimin e pjesëmarrjes në këtë aktivitet në datë 02.03.2023. Në këto kushte ka qenë i pamundur raportimi i dy aktivitetëve pesë ditë para zhvillimit të tyre.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Bashkia Korçë nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

23. Bashkia Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inspektim për fillimin e punimeve në përforcimin e pallateve tek lagjja “Gurra”, raportuar në datë 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.2.2023.*

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet e saj, Bashkia Lezhë nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se tematika e aktivitetit të raportuar me vonesë nga Bashkia Lezhë dhe nga informacionet e paraqitura në ndërfaqe, përbën veprimtari me karakter publik. Raportimi është kryer brënda 4 ditëve dhe jo 5 ditëve sikundër parashikon dispozita ligjore.

Për sa më lart, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, tërheq vëmendje Bashkisë Lezhë që në vijim të kryejë raportimet duke respektuar afatin 5 (pesë) ditor të përcaktuar në ligj.

24. Bashkia Malësi e Madhe ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Dhënia e titullit “Qytetar Nderi” për znj. Tole Junçaj”*, raportuar në datë 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.

Bashkia Malësi e Madhe, nëpërmjet email- it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“Për shkak të një gabimi njerëzor në llogaritjen e ditëve duke qenë fundi i muajit Shkurt nuk është respektuar afati 5 (pesë) ditor i raportimit sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, nga ana e personit raportues.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatoi se tematika e aktivitetit *“Dhënia e titullit “Qytetar Nderi” për znj. Tole Junçaj”* që është raportuar jashtë afatit ligjor, për sa informacion jepet në ndërfaqe, përbën veprimtari administrative që lidhet me veprimtarinë funksionale të institucionit.

25. Bashkia Maliq ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Kontroll punimesh për Rehabilitimin e kalldrëmeve dhe ndriçimit publik në Fshatin Kolanec”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 1.3.2023.
2. Aktivitet *“Inspektim punimesh për “Kanalizimin e Ujrave të Zeza”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 1.3.2023.
3. Aktivitet *“Inspektim Kontroll për mbetjet e mjedisit”*, raportuar në datë 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.

Bashkia Maliq, nëpërmjet email- it të datës 8.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“Ne lidhje me konstatimet e kryera nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju bëjme me dije se me shkresë nr. 3874 prot, datë 02.12.2023 të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 6071 prot, datë 05.12.2023 është kërkuar dërgimi i të dhënave të personit përgjegjës për raportim. Me shkresë nr. 6071/1prot, datë 09.12.2023 janë dërguar të dhënat e personit për raportim pranë KQZ. Nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nuk janë vendosur në dispozicion kredencialet për tu loguar në seksioni raportime. Nga ana jonë është dërguar email në datën 28.02.2023 pranë KQZ për pajisjen me kredenciale të personit përgjegjës për raportimet dhe ndryshimin e të dhënave të personit përgjegjës. Në datën 28.02.2023 ora 14:50 nga KQZ janë dërguar kredencialet për logim në faqen zyrtare të raportimeve në KQZ. Me vendosjen në dispozicion të kredencialeve për logim janë bërë menjëherë*

raportimet mbi aktivitetet që kryhen, nga institucioni Bashkia Maliq. Aktivitetet e dërguara nga ana juaj i përkojnë datave 01.03.2023 dhe 02.03.2023 të cilat kanë qenë e pamundur për tu raportuar sipas afatit që parashikon neni 92 i ligjit 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" pasi nuk kemi patur akses në faqen zyrtare raportime. Duke qenë se nga ana e KQZ nuk janë vendosur në dispozicion kredencialet për logim në faqen raportime, nga ana jone ka qenë e pamundur zbatimin i kësaj dispozite ligjore. Bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion provat faktike që vërtetojnë se nga ana jonë ka qenë e pamundur bërja e raportimeve sipas afateve ligjore."

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura konstaton se, Bashkia Maliq ka hasur probleme në marrjen e kredencialeve për të hyrë në ndërfaqen e raportimeve. Sipas hetimit të kryer, rezultoi se administrata e KQZ-së që në fillim të periudhës 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, nëpërmjet email-it aktivitet.kqz.gov.al, i ka dërguar Bashkisë Maliq, kredencialet për të aksesuar sistemin. Pavarësisht kësaj, sipas nenit 4, pika 5 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në kushtet kur është e pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, subjektet mund të dërgojnë raportimin nëpërmjet email – it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton situatën në të cilën është ndodhur Bashkia Maliq, megjithatë tërheq vëmendjen që në vijim të respektojë dispozitat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

26. Bashkia Mallakastër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *"Vlerësim nga Bashkia Mallakastër për mesuesit e dalë në pension, për kontributin e dhenë ndër vite!"*, raportuar në datë 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 6.2.2023.
- Aktivitet *"Aktivitet me karakter fetar"*, raportuar në datë 1.3.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.

Bashkia Mallakastër, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *"Përsa i përket aktivitetit të datës 6.3.2023 raportuar nga Bashkia Mallakastër në datën 28.2.2023 përlogaritja e afatit 5 (pese) ditor është bërë me ditë kalendarike e menduar se është brenda afatit ligjor. Aktiviteti i parashikuar për datën 4.3.2023 me karakter fetar i cili është raportuar me datë 1.3.2023 nga ana e institucionit tonë, ishte parashikuar për datën 4.3.2023, nuk është realizuar si aktivitet."*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se për aktivitetin e parë me temë *“Vlerësim nga Bashkia Mallakastër për mësuesit e dalë në pension, për kontributin e dhënë ndër vite!”*, është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Data e zhvillimit të aktivitetit është shënuar 6.2.2023 por duhet të ishte shënuar 6.3.2023, datë në të cilën është zhvilluar edhe aktiviteti. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së dhe vlerëson se raportimi është kryer brenda afatit ligjor. Lidhur me aktivitetin e dytë *“Aktivitet me karakter fetar ”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se aktiviteti nuk është zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

27. Bashkia Patos ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inspektim i Punimeve”*, raportuar në datë 24.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.2.2023.

Bashkia Patos, nëpërmjet email- it të datës 6.3.2023 dhe shkresës me nr. 670 prot., datë 06.03.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se, *“Ky aktivitet është raportuar nga personi përgjegjës më datë 24.02.2023 dhe është realizuar më datë 03.03.2023, pra 5 ditë përpara se të realizohej dhe nuk kemi tejkallim të afateve të raportimit. Deklarimi që është bërë për në datën 3.2.2023 ka ndodhur për shkak të pakujdesisë por edhe për shkak të formatimit që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë faqes ku bëhet raportimi. Data në sistem nuk shënohet në mënyrë manuale por klikohet mbi kalendar, në kalendarin që paraqitet në sistem nuk përcaktohet muaji por janë vetëm datat dhe për shkak të pakujdesisë është klikuar data 3.2.2023 dhe jo data 3.3.2023, pasi nuk ka kuptim që të deklarohet një aktivitet 21 ditë pasi është realizuar. Në përfundim theksojmë se ky aktivitet është raportuar në datë 24.2.2023 dhe është realizuar në datë 3.3.2023 pra 5 ditë përpara se të realizohej dhe nuk kemi tejkallim të afateve të raportimit. ”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e një lapsusi në hedhjen të dhënave, të kryer nga Bashkia Patos. Data e zhvillimit të aktivitetit është shënuar 3.2.2023, por duhet të ishte shënuar 3.3.2023, datë në të cilën është zhvilluar aktiviteti.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së dhe vlerëson se raportimi është kryer brenda afatit ligjor.

28. "Bashkia Pogradec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 7 (shtatë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet "Bashkia Pogradec në bashkëpunim me fondacionin Alsar do të mbjellin 25 fidanë të rinj pemësh në parkun e qytetit", raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.
2. Aktivitet "Një investim i ri në sektorin e Agroturizmit është duke u zbatuar në Pogradec. Si një investim i nevojshëm në funksion të turizmit, Kryetari i Bashkisë do të inspektojë punimet e subjektit", raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 27.2.2023.
3. Aktivitet "Pajtimi i Gjaqeve- aktivitet në Slabinjë të Pogradecit", raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023.
4. Aktivitet "Takim me Operatorët Turistikë të Pogradecit", raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.
5. Aktivitet "Dhurojmë trendafila për qytetarët e Pogradecit", raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023.
6. Aktivitet "Inspektim të punimeve në fshatin Slabinje, Pogradec", raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.
7. Aktivitet "Ekspozitë pikturë", raportuar më 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 6.3.2023.

Bashkia Pogradec, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar: *"Së pari duam t'iu sqarojmë se të gjitha aktivitetet të cilat na keni listuar, nuk kanë pasur në asnjë rast qëllime politike me pjesëmarrësit, por janë aktivitete të cilat përkujtojnë data, ngjarje apo edhe aktivitete të organizuara nga të tjera institucione dhe Bashkia ka qene e ftuar ne to. Për shkak se një pjesë e tyre kanë qene aktivitete të organizuara jo nga ne, këto institucione nuk janë në dijeni të urdhrit të KQZ për raportimin e aktiviteteve 5 ditë përpara, megjithatë ne për të qenë korrekt me institucionin tuaj i kemi raportuar ne ditët që na ka ardhur njoftimi i zhvillimit të aktivitetit. Për sa me sipër mund t'iu sqaroj se:*

1. *"Bashkia Pogradec në bashkëpunim me fondacionin Alsar do të mbjellin 25 fidanë të rinj pemësh në parkun e qytetit", raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023. Kjo Kjo ka qenë një dhurim nga Fondacioni Alsar me qendër në Tiranë, të cilët sic thashë me lart nuk janë në dijeni të shkreses se KQZ dhe e kanë njoftuar ardhjen e tyre vonë. Nuk ka qellim politik, apo pjesëmarrje qytetare, janë mbjellë thjeshtë fidanë te rinj pemësh.*

2. “Një investim i ri në sektorin e Agroturizmit është duke u zbatuar në Pogradec. Si një investim i nevojshëm në funksion të turizmit, Kryetari i Bashkisë do të inspektojë punimet e subjektit”, raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 27.2.2023. Ky inspektim ka ardhur me kerkese nga investitori privat, i cili po ashtu nuk është në dijeni të shkresës dhe jemi detyruar të njoftojmë ditën kur ata do të nisnin punimet e investimit në agroturizem.

3. “Pajtimi i Gjaqeve-aktivitet në Slabinjë të Pogradecit”, raportuar më 25.2.2023 dhe datë zhvillimi 28.2.2023. Aktivitet perkujtimor e zhvilluar dhe organizuar nga shkolla e Slabinjes, të cilët në njoftimin e tyre po ashtu nuk kanë dijeni për shkresën e si e tillë, është raportuar nga ne për pjesëmarrjen në datën që është raportuar në faqen e KQZ

4. “Takim me Operatorët Turistikë të Pogradecit”, raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023 -Eshtë një projekt i financuar nga fondet e BE dhe që përfshin tre bashkitë e liqenit të Ohrit, një takim që nuk organizohet nga Bashkia por nga donatorët me Operatoren e Pogradecit, kryetari i Bashkisë nuk ka marrë pjesë, por në raportim për të qenë korrekt me institucionin tuaj.

5. “Dhurojmë trendafila për qytetarët e Pogradecit”, raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 2.3.2023- Ketu kemi të bëjmë jo me aktivitet me karakter publik, por një nismë që Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacionit e cila është sh.a ka ndermarrë çdo vit për të dhuruar trendafila për qytetarët, aktiviteti nuk ka pasur asnjë prani të drejtuesve apo përfaqësuesve të Bashkisë Pogradec. Mund të verifikohet edhe në faqe që nuk ka asnjë postim për këto aktivitet.

6. “Inspektim të punimeve në fshatin Slabinje, Pogradec”, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023. Edhe pse në faqen tuaj është raportuar se do të zhvillohet ky inspektim ai nuk është realizuar, mund ta shikoni edhe në faqen e Bashkisë Pogradec që nuk ka asnjë postim për të.

7. “Ekspozitë pikturë”, raportuar më 2.3.2023 dhe datë zhvillimi 6.3.2023 -Eshtë një ekspozitë pikturë e cila realizohet nga Shoqata Antik me qendër në Fier, aktiviteti organizohet totalisht nga kjo shoqatë dhe Bashkia Pogradec i ka lejuar të vendosin punimet e pikturës në ambientet e Galerisë së Arteve të qytetit, pra nuk është aktivitet që realizohet nga institucioni jonë dhe për pasojë njoftimi ka ardhur me vonesë tek ne, kjo për faktin sepse shoqata nuk është në dijeni të përmbajtjes së shkresës së KQZ.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se për aktivitetet 1, 3, 4, 5 dhe 7, Bashkia Pogradec nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet, për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Lidhur me aktivitetin e dytë “Një investim i ri në sektorin e Agroturizmit është duke u zbatuar në Pogradec. Si një investim i nevojshëm në funksion të turizmit, Kryetari i Bashkisë do të inspektojë punimet e subjektit”, mbështetur në pretendimet e paraqitura dhe nga tematika e aktivitetit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se Bashkia Pogradec nuk ka patur mundësinë të raportojë brenda afatit 5 (pesë) ditor të përcaktuar në ligj.

29. Bashkia Rrogozhinë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Aktivitet Pastrimi”, raportuar më 27.2.2023 dhe datë zhvillimi 3.3.2023.

Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet email-it të datës 7.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Bashkia Rrogozhinë ka dijeni të plotë për detyrimin për të raportuar cdo aktivitet publik. Që prej datës 13.1.2023 dhe për këtë arsye jemi treguar të kujdesshëm për realizimin e këtij detyrimi në përputhje me ligjin. Sic mund të shikohet pranë faqes së KQZ-së, raportimi për aktivitetin në fjalë është kryer në datën 27.2.2023, ndërkohë dita kur është përcaktuar realizimi i tij është 3.3.2023. referuar ketu udhëzimeve të KQZ-së për raportimin e aktiviteteve. Nga personi përgjegjës për raportimin e aktiviteteve është marr si afat kohor dhe dita e raportimit deri në ditën e realizimit të aktivitetit, që përmbushte afatet 5 ditor të raportimit në KQZ të aktivitetit. Në respektim të afateve dhe për të mos lënë vend për paqartësi në lidhje me afatin e raportimit nga ana e drejtuesit të institucionit të Bashkisë Rrogozhinë, në bashkëpunim me drejtuesin e Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, u vendos që aktiviteti të shtyhet për datën 4.3.2023, ora 10:00 për të respektuar afatet që parashikon udhëzimi i KQZ-së. Duke ju referuar datës së raportimit të aktiviteti “Aktivitet Pastrimi” në KQZ, dhe datës së realizimit të këtij aktiviteti nga ana jonë si institucion janë respektuar afatet 5 ditore të vendosura nga ana juaj për raportimet e aktiviteteve. Bashkëlidhur postimi në rrjetin social Facebook të kryetarit Edison Memolla.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, konstaton se aktiviteti i raportuar me vonesë ka ardhur si pasojë e përlllogaritjes së gabuar të afatit 5 (pesë) ditor. Megjithatë, rezulton që Bashkia Rrogozhinë e ka shtyrë aktivitetin dhe e ka zhvilluar atë në datë 4.3.2023.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

30. Bashkia Sarandë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Takim me donatorët qe kontribuan në rinovimin e Muzeut të kësaj shkolle me emër në shkallë vendi me histori 63-vjecare. Shpërndarje e certifikatave mirënjohje për të gjithë donatorët.”*, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 6.2.2023.
- Aktivitet *“Aktivitet përmbyllës i konkursit së pikturës “Artisti i vogël”*, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 6.2.2023.

Bashkia Sarandë nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Bashkia Sarandë më datë 28.02.2023 (duke respektuar afatin ligjor jo më vonë se 5 ditë nga zhvillimi i aktiviteteve) ka raportuar kryerjen e dy veprimtarive publike të cilat do të zhvillohen më datë 06.03.2023 me rastin e 7 Marsit, ditës së mësuesit, vendosja e datës së zhvillimit të këtyre dy veprimtarive më datë 06.02.2023 është lapsus i bërë nga ana jonë, pasi në përshkrimin shkurtimisht të këtyre veprimtarive publike “Takim me donatorët për restaurimin e muzeut të Gjimnazit “Hasan Tasini” dhe “Aktivitet përmbylles i konkursit të pikturës “Artisti i vogël” është përmendur se këto aktivitete do të zhvillohen me rastin e 7 Marsit, ditës së Mësuesit”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstaton se në të dy aktivitetet e raportuara, është kryer një lapsus në hedhjen e të dhënave në sistem. Data e zhvillimit të aktivitetit është shënuar 6.2.2023 por duhet të ishte shënuar 6.3.2023, datë në të cilën është zhvilluar aktiviteti. Mbështetur edhe në tematikën e veprimtarive lidhur me festën e 7-8 marsit, Komisioneri mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së dhe vlerëson se raportimi është kryer brenda afatit ligjor.

31. Bashkia Tepelenë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Takim me banorët e Njesisë Administrative Lopës, fshati Sinanaj”*, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.
- Aktivitet *“Takim me veteranë të Njesisë Administrative Qytet”*, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023.

Bashkia Tepelenë, nëpërmjet email-it të datës 6.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Në përgjigje të kërkesës për paraqitje pretendimesh në procesin administrativ lidhur me raportimet e veprimtarive që do të kryhen nga bashkia Tepelenë , si vijon:“Takim me banorët e Njesisë Administrative Lopes, fshati Sinanaj”, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023. Takim me veteranë të Njesisë Administrative Qytet”, raportuar më 28.2.2023 dhe datë zhvillimi 4.3.2023. Ju bëjme*

me dije se nga ana jonë raportimet jane kryer ne date 28.02.2023 ora 09.00 dhe për këtë arsye kemi menduar se korrespondojne me 5 ditë njoftim paraprak.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet vlerëson se, vonesa e raportimit të veprimtarisë publike ka ardhur nga llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati. Konstatohet se Bashkia Tepelenë ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, duke u përpjekur për të mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, i tërheqim vëmendjen Bashkisë Tepelenë që në vijim, të kryejnë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- b) Ministria e Financës dhe Ekonomisë,
- c) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
- ç) Ministria E Turizmit,
- d) Ministria Kulturës,
- dh) Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët,
- e) Banka e Shqipërisë,
- ë) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë,
- f) Agjencia Shtetërore e Kadastrës,
- g) Prefekti i Qarkut Tiranë,

- gj) Autoriteti i Aviacionit Civil,
 - h) Qendra Kombëtare e Biznesit-Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike,
 - i) Drejtoria Rajonale Arsimit Parauniversitar Korçë,
 - j) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier,
 - k) Bashkia Tiranë,
 - l) Bashkia Belsh,
 - ll) Bashkia Dibër,
 - m) Bashkia Divjakë,
 - n) Bashkia Durrës,
 - nj) Bashkia Gjirokastër,
 - o) Bashkia Kavajë,
 - p) Bashkia Korçë,
 - q) Bashkia Lezhë,
 - r) Bashkia Malësi e Madhe,
 - rr) Bashkia Maliq,
 - s) Bashkia Mallakastër,
 - sh) Bashkia Patos,
 - t) Bashkia Pogradec,
 - th) Bashkia Rrogozhinë,
 - u) Bashkia Sarandë,
 - v) Bashkia Tepelenë,
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI